



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Liqeni VII” sh.a

Adresa: Durrës, Shkozë, L.14

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” **“Rikonstruksioni i rrugës “Dhimitër Shuteriqi”.**

Numri i referencës së procedurës/lotit REF-72523-05-30-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: **“Rikonstruksioni i rrugës “Dhimitër Shuteriqi”.**

Fondi limit: 44,962,272 (dyzet e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 4 (katër) muaj kalendarikë duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 02.07.2018, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 22 datë 04.06.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomike më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Erges MAT” shpk

NUIS K17614913O

Vlera e ofertës = **0** (Zero) lekë.

2. Operatori ekonomik “Shendelli” shpk

NUIS K07924803N

Vlera e ofertës = **34,532,002** (tridhjetë e katër milion e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e dy) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk

NUIS K51712017A

Vlera e ofertës = **37,249,949.80** (tridhjetë e shtatë milion e dyqind e dyzet nëntë mijë e nëntëqind e dyzet e nëntë pikë tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Liqeni VII” sh.a.

NUIS K01730502W

Vlera e ofertës = **37,509,130.96** (tridhjetë e shtatë milion e pesëqind e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Bahas” shpk

NUIS J61827083D

Vlera e ofertës = **37,693,417** (tridhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i operatorëve ekonomik “2AF Albania Group” shpk & “ALB LEAA International” shpk

NUIS L32005501M & J86906408N

Vlera e ofertës = **37,998,441** (tridhjetë e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dyzet e një) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk

NUIS K02003001O

Vlera e ofertës = **38,531,532.70** (tridhjetë e tetë milion e pesëqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind e tridhjetë e dy pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

8. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “SMO Vataksi” shpk & “SMO Union” shpk

NUIS L47022001J & J66902042Q

Vlera e ofertës = **40,636,547** (dyzet milion e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomikë “Erges MAT” shpk

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 0 (zero) lekë.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Erges MAT” shpk, ka paraqitur në sistemin elektronik vetëm Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.

Mungesa e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik si dhe mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomikë “Shendelli” shpk.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e stafit teknik, konstatoi se Inxhinieri i Ndërtimit i deklaruar nga Operatori ekonomik “Shendelli” shpk nuk është i profilit transport, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin Autobitumatriçe, konstatoi se shoqëria “Shendelli” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “b”. Ka deklaruar vetëm mjet Bitumatrice dhe jo Autobitumatrice.
- Asnje ga kamioncinat e deklaruar ne Shtojcen Nr.10 nuk ploteson kapacitetin e kerkuar. Kamioncina me targe AA347KE 1,9 ton, kamioncina me targe AA959GS 1,2 ton, kamioncina me targe AA074PU 1,3 ton. Per kamioncinen të deklaruar ne pronesi me targe AA693OY nuk eshte paraqitur dokumentacion. Per kamioncinen te deklaruar si të marrë me qera me anë të kontratës së qerasë Rep.536, Kol 218 nuk është paraqitur dokumentacion.

3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomikë “Kacdedja” shpk

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e stafit teknik, konstatoi se Inxhinieri i Ndërtimit i deklaruar nga Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk është i profilit transport, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin Autobitumatriçe, konstatoi se shoqëria “Kacdedja” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “b”.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autovinç me targa TR 9082 T. Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin e deklaruar si më lart, KVO konstatoi se ka mbaruar afati i vlefshmerise se siguracionit te mjetit konkretisht me date 23.05.2018, si dhe afati i vlefshmerise se Kontrollit teknik te mjetit me date 29.05.2018. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 14, germa a), ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; **c) çertifikatën e kontrollit teknik;** **d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);** e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene

aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk ka deklaruar se disponon 5 (pesë) kamionçina përkatësisht me targa AA 479 EU, AA 174JD, AA2530X, TR1952T si dhe AA 603 FT. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruar si më lart, KVO konstatoi se kamionçina me targë AA 479 EU ka kapacitet mbajtës 0.4 ton, kamionçina me targë AA 174JD ka kapacitet mbajtës 0.8 ton, kamionçina me targë AA2530X ka kapacitet mbajtës 1 ton, kamionçina me targë TR1952T ka kapacitet mbajtës 0.9 ton, ndërsa mjeti me targë AA 603 FT ka kapacitet mbajtës 1.6 Ton. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: **“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”**.

4. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomikë “Bahas” shpk.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e stafit teknik, konstatoi se Inxhinieri i Mjedisitë deklaruar nga Operatori ekonomik “Bahas” shpk nuk posedon Çertifikatë për Vlerësimin e Ndikimit çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e stafit teknik, konstatoi se Inxhinieri i Ndërtimit i deklaruar nga Operatori ekonomik “Bahas” shpk nuk është i profilit transport, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin Autobitumatriçe, konstatoi se shoqëria “Bahas” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “b”. Ka deklaruar vetem mjet Bitumatrice dhe jo Autobitumatrice.
- Kamioncina me targe TR5154L e angazhuarr tek procedura per te cilen eshte shpallur fitues me objekt; “Thellimi I kanalit ne Shkoze”. Kamioncina me targe AA856GK nen kapacitetin e kerkuar, 0,9 ton, kamioncina e marre me qera me targe AA289RL 1,2 ton dhe kamioncina e marre me qera mbi kapacitetin e kerkuar, me targë AA218 LM 5,1 ton.

5. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomik “2AF Albania Group” shpk & “ALB LEAA International” shpk

- Operatori ekonomik “2AF Albania Group” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik Vërtetim Debie me Nr. 1871 Prot. datë 18.06.2018 sipas së cilës rezulton se nuk ka detyrime për faturat e energjisë elektrike deri në datën 18.06.2018 pa përfshirë faturën koherente të muajit Maj 2018. Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të

konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

- Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit të publikuar më datë 31.05.2018 dhe zhvilluar më datë 02.07.2018.
- Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “2AF Albania Group” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, gërma “e” të vendosur në DST, ç’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e stafit teknik, konstatoi se Inxhinieret e Ndërtimit të deklaruar nga Bashkimi i Operatoreve ekonomik “2AF Albania Group” shpk dhe “Alb LEAA Internacional” shpk nuk janë të profil të transport, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Bashkimi i Operatoreve ekonomik “2AF Albania Group” shpk dhe “Alb LEAA Internacional” shpk nuk plotëson Piken 6 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, ku përcaktohet që ofertuesit duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues, KVO konstatoi që dokumentacioni Urdheri i Mjekut rezulton i pavlefshëm për mjekun e shoqërisë “Alb LEAA Internacional” shpk, vlefshmeria ka përfundur 07.11.2017, ndërsa për mjekun e shoqërisë “2AF Albania Group” shpk, vlefshmeria e Urdherit të Mjekut ka përfunduar me datë 02.07.2017.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatoreve ekonomik “2AF Albania Group” shpk dhe “Alb LEAA Internacional” shpk ka deklaruar se disponon 3 (tre) kamionçina përkatësisht me targa AA 298 HM, AA 129 LS, si dhe AA1520 OV. Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetet e deklaruar si më lart, KVO konstatoi se kamionçina me targë AA 298 HM ka kapacitet mbajtës 2 ton, kamionçina me targë AA 129 LS ka kapacitet mbajtës 1 ton, kamionçina me targë AA1520 OV ka kapacitet mbajtës 1.2 ton. Për sa më lart, Bashkimi i Operatoreve ekonomik “2AF Albania Group” shpk dhe “Alb LEAA Internacional” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”.
- Referuar Shtojcës 10, Bashkimi i Operatoreve ekonomik “2AF Albania Group” shpk dhe “Alb LEAA Internacional” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobitumatriçe, me

targa AA673 RE. Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin e deklaruar si më lart, KVO konstatoi se është paraqitur vetëm kontrata e qerasë date 29.06.2018, me Nr. 5272 Rep. dhe Nr.4204 Kol. e pa shoqëruar me dokumentat tekniko – ligjore të mjetit, çka bie në kundërshtim me piken 15, germa a), ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes si dhe germa b) Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

6. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e stafit teknik, konstatoi se Inxhinieri i Ndërtimit i deklaruar nga Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk nuk është i profilit transport, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” ka deklaruar në Shtojcën Nr. 10 se disponon Autobot Uji të montuar = Kamion me targa AA 418UC + depozitë uji, si dhe dokumentat janë paraqitur të pashoqëruara me vertetimin e njëshmimit me origjinalin, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku ndër të tjera është kërkuar që “Operatorët ekonomik pjesmarrës duhet të disponojnë Autobot Uji I (një) copë”.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin “Kamionçina me kapacitet mbajtës min 3.5-5 ton, me targa AA 228 JJ”, konstatoi se nuk është paraqitur certifikata për transport mallrash brenda vëndit çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, germa a), ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Shoqëria “Eurondertimi 2000” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) kamionçinë me targa AA654 RX. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin e deklaruar si më lart, KVO konstatoi se Kamionçina me targë AA654 RX ka kapacitet mbajtës 5.4 Ton; Për sa më lart, Operatori ekonomik “Euro ndertimi 2000” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) kamionçina

me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”.

- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetet e deklaruar në Shtojcen Nr.10, u konstatua se për mjetin Autobitumatriçe është paraqitur dokumentacion për “Bitumatriçe”, vetëm me fature zhdoganimit, nuk ka dokumentacion për mjetin autobitumatriçe, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15,
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin “Eskavator me goma”, të deklaruar në Shtojcen Nr.10, u konstatua se janë paraqitur vetëm me faturë zhdoganimit dhe jo dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, germa a), ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.

7. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë “SMO Vataksi” shpk & “SMO Union” shpk

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e stafit teknik, konstatoi se Inxhinieret e mjedisit të deklaruar nga bashkimi i operatoreve ekonomike nuk posedojnë Certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5. Është paraqitur Certifikata për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për Inxhinierin Mekanik.
- KVO konstatoi se diploma e Inxhinierit të Topograf të paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve ekonomik është fotokopje, çka bie në kundërshtim me DST ku përcaktohet se: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”*
- Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit teknik, u konstata se mungon Libreza e Punës për Inxhinierin Hidroteknik, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “SMO Union” & “SMO VATAKS” nuk plotëson pikën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit, tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm”, pasi Diploma dhe Urdheri i Mjekut janë paraqitur fotokopje e pa shoqëruar me vërtetimin e noterizimit/njehsimit të fotokopjes me origjinalin çka bie në

kundërshtim me Kriterin e paraqitur në Dokumentat standarte të Tenderit: “*Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre*”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatori ekonomik “**Liqeni VII**” **Sh.a** me adresë: Durrës, Shkozë, L.14, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **37,509,130.96** (tridhjetë e shtatë milion e pesëqind e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë pike nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodë Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 17.07.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk u paraqit asnjë ankesë.

